



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.40/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.01.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kundërshtimi i vendimit e Komisionit të Vlersimit të Ofertave lidhur me vlerësimin në pikë të ofertës së operatorit ekonomik “Victoria Invest International” shpk dhe vlersimin në pikë të ofertës së BOE “Xhast shpk& “Alb-Shpresa” shpk & “Mela” shpk në procedurën e prokurimit “E Kufizuar (mbi kufirin e larte monetar)”, me nr. REF-65730-07-16-2020, me objekt “Loti 3 : “Mirëmbajtje me performancë Tiranë - Dajt - Qafë Mollë - Bizë, Qafë Priskë - Shkallë – Shëngjergj, Uzina e Traktorit - Lanabregas, Sauk - Farkë”, me fond limit 255,787,340.00 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 04.11.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: “Victoria Invest International” shpk
Lagjia “28 Nentori”, Rr “11 Nentori”, Pallati Prane
Tatim Taksave, Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “E Kufizuar (mbi kufirin e larte monetar)”, me nr. REF-65730-07-16-2020, me objekt “Loti 3 : “Mirëmbajtje me performancë Tiranë - Dajt - Qafë Mollë - Bizë, Qafë Priskë - Shkallë – Shëngjergj, Uzina e Traktorit - Lanabregas, Sauk - Farkë”, me fond limit 255,787,340.00 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 04.11.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr. 10024/1 datë 28.12.2020 si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 07.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Nga data 07.8.2020 deri në datë 31.08.2020 KVO shqyrtoi në sistem të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit pjesmarrës në fazën e parë. Në këtë fazë kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar/skualifikuar operatorët si më poshtë.

- | | |
|---------------------------------|----------------|
| - Victoria Invest International | I kualifikuar |
| - Sireta -2F | I skualifikuar |
| - Ante Group | I skualifikuar |
| - Rosi | I kualifikuar |
| - Gjoka Konstruksion | I kualifikuar |
| - Xhast&Alb Shpresa&Mela | I kualifikuar |
| - Igma | I skualifikuar |

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 22.09.2020 KVO ka kryer rivlerësimin e ofertave në zbatim të vendimit nr.6533/1 prot datë 18.09.2020 të KSHA i cili ka vendosur skualifikimin e operatorëve ekonomikë Gjoka Konstruksion , Rosi Spa Albania. Në përfundim të rivlerësimit operatorët ekonomikë të skualifikuar janë si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------|----------------|
| - Victoria Invest International | I kualifikuar |
| - Sireta -2F | I skualifikuar |
| - Ante Group | I skualifikuar |
| - Rosi | I skualifikuar |
| - Gjoka Konstruksion | I skualifikuar |
| - Xhast&Alb Shpresa&Mela | I kualifikuar |
| - Igma | I skualifikuar |

II.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pas mbylljes së fazës së parë dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor më datë 16.10.2020 me shkresën nr.4794/23 nëpërmjet sistemit elektronik ka drejtuar tek operatorët ekonomikë ftesën për ofertë. Data e përcaktuar për hapjen e ofertave është data 04.11.2020 ora 11:00. Operatorët që i janë përgjigjur ftesës për dorëzimin e ofertës ekonomike janë:

- Victoria Invest International 220,632,361.920
- Xhast&Alb Shpresa&Mela 249,735,000

Në datën 04.11.2020 është zhvilluar faza e dorëzimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës.

II.5. Në datën 23.11.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. BOE Xhast&Alb-Shpresa&Mela shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	249,735,000	88	100	100	288
2	249,735,000	88	100	100	288
3	249,735,000	89	100	100	289

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 288.333 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	249,735,000	52.8	20	20	92.8
2	249,735,000	52.8	20	20	92.8

3	249,735,000	53.4	20	20	93.4

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 93 pikë.

2. Victoria Invest International

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	181,127,041.2	100	100	70	270
2	181,127,041.2	100	100	70	270
3	181,127,041.2	100	100	70	270

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 270 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	181,127,041.2	60	20	14	94
2	181,127,041.2	60	20	14	94
3	181,127,041.2	60	20	14	94

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 94 pikë.

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	Victoria Invest	270	94

	International		
2	BOE Xhast&Alb-Shpresa&Mela shpk	288.333	93

- *Argumentet për pikëzimin nga KVO- Lidhur me kriterin Cilësia OE “Victoria Invest International” shpk ka paraqitur dokumentin e metodologjisë i përshkruar në 25 faqe. Ky dokument është identik me atë të paraqitur nga subjekti Victoria Invest shpk në lotin 4 dhe paraqet të njëjtat të meta. Aty nuk gjejmë të përshkruar akset rrugore përbrës të kontratës , nuk përshkruhet pozicionimi i kantiereve të përkohshëm (PMM) sidomos ato të dislokimit të mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të mirmbajtjes dimërore etj. Përvec të tjerave në faqen 4 të tij thuhet se do të ngrihen 2 qendra të mirëmbajtjes (Pikat e mbështetjes dhe mirëmbajtjes PMM) në kuptimin e kantiereve të cilat do të shërbejnë si pika ndërhyrjeje të domosdoshme sidomos në sezonin dimëror. Në vijim përshkruhet vetëm njëra nga këto kantiere dhe konkretisht ai në Elbasan, (ndërkohë që të gjitha segmentet rrugore të kontratës shtrihen në teritorin e Bashkisë Tiranë dhe konkretisht në pjesën lindore në malin e Dajtit dhe më tej. Pra ky përshkrim përvec se është i gabuar ai është dhe i paplotë (-3 pik). Në vazhdim nuk evidentohet në asnjë dokument plani i sigurimit teknik (-1 pik). Gjithashtu mungon plani i menaxhimit të aksidenteve dhe ndihmës së shpejtë (-1 pik). Gjithashtu mungon plani i menaxhimit social dhe mjedisor (-1 pik). Dokumenti me planin e menaxhimit të cilsisë është paraqitur si një material i përkthyer nga gjuha e huaj (i papërshtatur me gjuhën shqipe). Në total për këtë kriter zbriten 6 pikë.*

II.6. Në datën 10.12.2020 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kryer procesin e rivlerësimit të procedurës në zbatim të vendimit nr.9242/2 prot datë 07.12.2020 të KSHA me pikët si më poshtë:

2. BOE Xhast&Alb-Shpresa&Mela shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	249,735,000	88	100	100	288
2	249,735,000	88	100	100	288
3	249,735,000	89	100	100	289

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 288.333 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	249,735,000	52.8	20	20	92.8
2	249,735,000	52.8	20	20	92.8
3	249,735,000	53.4	20	20	93.4

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 93 pikë.

2. Victoria Invest International

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	181,127,041.2	100	100	45	245
2	181,127,041.2	100	100	45	245
3	181,127,041.2	100	100	45	245

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 245 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
------------------	------------------	-----------------------	-----------------------------------	--	------------

			në %		
1	181,127,041.2	60	20	9	89
2	181,127,041.2	60	20	9	89
3	181,127,041.2	60	20	9	89

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 89 pikë.

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	BOE Xhast&Alb-Shpresa&Mela shpk	288.333	93
2	Victoria Invest International	245	89

Argumentimi i KSHA lidhur me uljen me -5 pikë të komponentit të tretë Cilësia të OE "Victoria Invest International":

Lidhur me pretendimin e BOE Xhast & Alb Shpresa&mela shpk me kërkesën: Kundërshtojmë vlerësimin e bërë për operatorin tjetër Victoria Invest International dshh pasi komisioni duhet ti jepte më pak pikë lidhur me disponueshmërinë e mjeteve. Nga informacionet tona ky operator ka paraqitur mjete të kompanisë mëmë në shtetin e Kosovës dhe mjete të tjera me qera të cilat janë të angazhuara në kontrata për mirëmbajtjen e rrugëve në Kosovë. Për këtë ky operator është në kushtet e deklaratës së re me për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës dhe sipas dt në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13 pika 3 gërma a e LPP".... KSHA morri në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në SPE si dhe kërkoi nëpërmjet postës elektornike informacion në Departamentin e Menaxhimit të Rrugëve , Ministria e Infrastrukturës në Kosovë. Nga krahasimi i informacionit të ardhur në postën elektronike në datën 03.12.2020 me dokumentacionin e paraqitur në SPE rezultuan konstatimet e mëposhtme:

OE Victoria Invest International dshh ka paraqitur deklaratën e mjeteve nga e cila rezulton se ka mjete në pronësi dhe me qera. Këto të fundit midis të tjerave janë marrë me qera në shtetin e Kosovës nga kompani të cilat ushtrojnë aktivitet në ndërtim dhe mirëmbajtje rruge. Kontrata e qerasë me një nga kompanitë në shtetin e Kosovës nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve. Megjithatë referuar kopjeve të dokumentacionit të mjeteve dhe makinierive të kompanisë qeradhënëse rezulton se janë të angazhuara nga vetë qeradhënësi Damastion Project

shpk në kontratën e mirëmbajtjes aktive në Republikën e Kosovës cka pas sjell që deklarata e bërë nga ana e OE Victoria Invest International shpk, dshh mbi disponueshmërinë e mjeteve të jetë në kushtet e deklaratës së rreme. Në vijim jepet lista e mjeteve të deklaruara të cilat rezultojnë të angazhuara nga vetë qeradhënësi Damastion Project shpk...mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton, grejder, kamioncinë deri 3.5 ton, eskavator me goma, fadromë, eskavator me zinxhir.

Nga sa më sipër nuk provohet disponueshmëria e mjeteve nga OE Victoria Invest International shpk dshh dhe referuar metodikës së pikëzimit, KVO duhet të bëjë rivlerësimin e pikëve lidhur me kriterin e cilësisë duke penalizuar edhe me 5 pikë këtë operator.

II.7. Në datën 27.11.2020 operatori ekonomik “Victoria Invest International” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me pretendimet si më poshtë:

- *Për sa i përket vlerësimit të KVO për cmimin më të ulët me 60 pikë ekuivalente me 100% dhe cmimit më të shtrenjtë me 53.01 pikë ekuivalente 88.35 % ju theksojmë se ky lloj vlerësimi nuk përputhet me kriteret e AK të paraqitur në DT. Pasi vetë AK në DT ka shprehur që vlerësimi për cmimindo të jetë nga 0 pikë deri në 60 pikë që nënkupton që OE që do të ofertojë me cmim më të lartë (afër fondit limit) do të ketë vlerësim më të vogël (afër 0 pikëve) dhe OE që do të ketë cmimin më të uët do të ketë pikët maksimale. Ju bëjmë me dije se OE Victoria Invest International ka ofertuar cmimin më të ulët (përkatesisht me 13.74% ulje nga fondi limit) nga të gjithë OE të tjerë dhe si pasojë është vlerësuar me 60 pikë ndërkohë që operatori më i shtrenjtë me 53.01 pikë apo 88.35 %. Dmth edhe nqs një OE është më i shtrenjti është penalizuar vetëm me 11.65%.*
- *Mënyra e vlerësimit nuk është bërë në përputhje me DT që OE më i shtrenjtë të vlerësohet me pikët minimale. Prandaj kërkojmë rishikim të vlerësimit për operatorët e tjerë ekonomikë duke i ulur pikët e dhëna nga KVO. Për këtë arsye kërkojmë që KVO të bëjë vlerësim real dhe pafavorizime duke i ulur pikët e dhëna nga KVO për BOE Xhast shpk& Alb Shpresa shpk& Mela shpk.*
- *Përvoja në punë e kompanisë 0-20 pikë*
Sipas vlerësimit të KVO
Victoria Invest International shpk 20 pikë (100%)
Xhast shpk&Alb Shpresa shpk&Mela shpk 20 pikë (100%).
Sipas procesverbalit të KVO për këtë kriter përcaktohet se vlerësimi për këtë kriter është bërë midis kompanive konkurruese:
8 pikë për punë të ngjashme në ndërtim , rikonstruksion, riveshje asfaltime
12 pikë për punë të ngjashme mirëmbajtje rrugë.
Shoqëria jonë ka paraqitur CV referenca për punët e kryera në 10 vitet e fundit dhe kemi marrë maksimumin e pikëve. Punime të ngjashme në mirëmbajtjet rrugore në vlerën totale 623,064,614 lekë.

Ndërtesa punime të ngjashme në ndërtim , rikonstruksion , riveshje, asfaltime sipas referencave të kontratave të përfunduara me vlerë totale 4,939,838,331 lekë me tvsh.

Përsa i përket referencave të punëve të ngjashme të BOE Xhast&Alb Shpresa shpk& Mela shpk (të cilat janë të pasqyruar në buletinet e app që i kemi bashkëngjitur ankesës) Punë të ngjashme për mirëmbajtje rrugore të BOE Xhast&Alb Shpresa&Mela shpk me vlerë totale 119,143,895 lekë për Xhast&Alb Shpresa shpk &mela të marra sa bashku dhe Alb Shpresa shpk në BOE me Eral Construction shpk dhe Ekskluziv shpk 108,658,859 lekë por Alb Shpresa shpk në asnjë rast nuk ka qenë kryesues dmth ka patur përqindje me të vogël në BOE me këto dy shoqëri. Për këto kontrata Alb Shpresa shpk nuk ka bërë asnjë deklaram të punimeve/ shërbimevetë kryera me anë të faturave tatimore (I kërkojmë AK të verifikojë kontratat e bashkëpunimit dhe vlerën e realizuar nga Alb Shpresa shpk. Pra këto kontrata mirëmbajtje rrugore nuk mund të merren me vlerë të plotë pasi nuk janë realizuar nga Alb Shpresa shpk. Si rrjedhojë vlera e punimeve të mirëmbajtjeve të këtij BOE në rastin më të mirë të mundshëm nuk mund të arrijë as 20% të vlerës së punimeve mirëmbajtje rrugore të Victoria Invest International. Punë të ngjashme në ndërtim, rikonstruksion, riveshje, asfaltime me vlerë totale 250,125,987 lekë me tvsh. Ndërsa BOE Xhast shpk &Alb Shpresa&Mela shpk megjithëse janë bashkuar 3 firma nuk kanë referenca punimesh në raport me shoqërinë Victoria Invest International shpk ndonëse pikët janë dhënë njësoj nga KVO nga 20 pikë secili.

Alb Shpresa shpk sipas ekstraktit të QKB ka shtuar në datë 26.07.2018 te objekti: mirëmbajtje rrugësh dhe mirëmbajtje dimërore rrugësh.

Xhast sipas ekstraktit të QKB ka shtuar në datë 16.07.2018 te objekti mirëmbajtje rrugësh

Mela shpk sipas ekstraktit të QKB ka shtuar në datë 26.07.2018 te objekti : mirëmbajtje rrugësh dhe mirëmbajtje dimërore rrugësh

Pra BOE Xhast&Alb Shpresa shpk& Mela shpk vetëm mbas korrikut 2018 kanë patur te objekti i aktivitetit sipas tenderit objekt ankese ndërsa kriteri i DT është përvoja në punë për 10 vitet e fundit.

KVO ka vlerësuar këtë BOE me pikët maksimale me kontrata punimesh rrjeti elektrik gropa pallatesh dhe rikonstruksione zyresh apo ndërtesash të cilat nuk përkrijnë fare me objektin e prokurimit. KVO ka gabuar në vlerësimin e njëjtë që i ka bërë shoqërisë tonë me eksperiencë mbi 10 vjet në mirëmbajtje rrugore dhe BOE Xhast&Alb Shpresa&Mela të cilët megjithëse janë bashkuar 3 firma nuk kanë ato referenca mirëmbajtje rrugore sa shoqëria Victoria Invest International (vlera e punëve të ngjashme në mirëmbajtje dhe në ndërtim BOE Xhast&Alb Shpresa&Mela shpk nuk arrijnë as 20% të vlerës së punëve të ngjashme të OE Victoria Invest International shpk).

KVO ka gabuar kur vlerëson BOE Xhast shpk &Alb Shpresa &Mela shpk me 20 pikë të cilët kanë marrë pjesë 3 shoqëri duke bashkuar të tre referencat e punimeve me eksperiencë në punime mirëmbajtje rrugore vetëm në 4 vitet e fundit dhe OE Victoria

Invest International shpk me 20 pikë e cila ka konkurruar e vetme dhe ka eksperiencë mbi 10 vjet në punë mirëmbajtje.

Lidhur nga ky fakt BOE Xhast shpk & Alb Shpresa & Mela shpk duhet të ketë koeficient /përqindje më të vogël pikësh për këtë kriter. Ju kërkohet që të merrni parasysh këtë fakt dhe të bëni rivlerësim të pikëve për këtë kriter.

Vlerësimi që duhet të bënte KVO sipas metodës së aplikuar nga ana juaj për vlerësimin e ofertave duhet të ishte përkatësisht:

*Viktoria Invest me vlerë punimesh të ngjashme në mirëmbajtje 623,064,614 dhe vlerë të ngjashme në ndërtim rikonstruksion riveshje asfaltme 4,939,838,331: **12 pikë (100%) për të ngjashme në mirëmbajtje dhe 8 pikë (100%) në të ngjashme në ndërtim rikonstruksion riveshje asfaltme.***

*BOE Xhast shpk & Alb Shpresa & Mela me vlerë punimesh të ngjashme në mirëmbajtje 119,143,895 dhe vlerë të ngjashme në ndërtim rikonstruksion riveshje asfaltme 250,125,987: **2.28 pikë pikë (19%) për të ngjashme në mirëmbajtje dhe 1.52 pikë (5%) në të ngjashme në ndërtim rikonstruksion riveshje asfaltme.***

Ju kërkohet që të bëni vlerësimin e këtij kriteri për BOE Xhast & Alb Shpresa & Mela sipas vlerësimit të bërë në procedurat e tjera të mirëmbajtjeve rrugore zhvilluara së fundmi nga ana juaj (gusht 2020-nëntor 2020 dhe përfundimisht ta vlerësoni BOE Xhast shpk & Alb Shpresa & Mela shpk për kriterin përvoja në punë e kompanisë me 2.28 pikë për punë të ngjashme mirëmbajtje rrugore dhe 1.52 pikë për punë të ngjashme në ndërtim rikonstruksion riveshje asfaltme.

Ju kërkohet që të bëni rivlerësim të BOE Xhast & Alb Shpresa & Mela për kriterin përvoja në punë e kompanisë duke e vlerësuar me 3.8 pikë (dhe me llogaritjet përkatëse sipas përqindjes dhe vlerës së ofertuar).

- *Cilësia (0-20 pikë)*

Sipas KVO vlerësimi për këtë kriter është

<i>Viktoria Invest International shpk</i>	<i>14 pikë (70%)</i>
<i>BOE Xhast & Alb Shpresa & mela</i>	<i>20 pikë (100%).</i>

Sipas procesverbalit të KVO Viktoria Invest International shpk është penalizuar me 6 pikë minus për metodologjinë. Pretendimi i KVO i cili thotë që: Viktoria Invest International shpk ka paraqitur dokumentin e metodologjisë i përshkruar në 25 faqe dhe se ky dokument është identik me atë të paraqitur nga subjekti Viktoria Invest shpk në lotin 4 dhe që paraqet të njëjtat të meta. Ku nuk gjenden akset rrugore të kontratës , nuk përshkruhet pozicioni i kantierëve të përkohshëm (PMM) sidomos ato të dislokimeve të mjeteve , pajisjeve dhe materialeve të mirëmbajtjes dimërore etj. Përveç të tjerave pretendon se në fq 4 të kësaj metodologjie thuhet se do të ngrihen 2 qendra mirëmbajtje në kuptimin e kantierëve të cilat do të shërbejnë si pika ndërhyrje të domosdoshme sidomos në sezonin e dimrit , në vijim përshkruhet vetëm njëra nga

këto. Dhe për këtë arsye KVO e cilëson të paplotë dhe të pasaktë dhe e penalizon OE Victoria Invest International me -3 pikë.

Pretendimit të mësipërm të KVO që Victoria Invest International shpk ka paraqitur dokumentin e Metodologjisë i përshkruar në 25 faqe dhe se ky dokument është identik me atë të paraqitur nga subjekti Victoria Invest shpk në lotin 4 , ju theksojmë se OE Victoria Invest International shpk ka paraqitur në AK dokumentat si më poshtë për cilësinë:

- *Përshkrimin e metodologjisë skica dhe planin e punës 25 faqe*
- *Planin e menaxhimit të cilësisë 29 faqe*
- *Planin e sigurimit të cilësisë 7 faqe*
- *Shëndeti dhe siguria në punë 26 faqe*
- *Metodologjia e punëve rutinë dhe punëve të rehabilitimit 19 faqe*
- *Plani i mobilizimit dhe grafiku i punimeve 3 faqe*

Sipas dokumentave të dorëzuara për kriterin iii) cilësia OE Victoria Invest International nuk ka dorëzuar një material me 25 faqe sic pretendon KVO por ka dorëzuar 6 materiale ku së bashku përbëjnë 109 faqe. Të gjitha këto janë në përputhje me objektin e prokurimit dhe me specifikimet teknike të dhëna nga AK.

- *Pretendimi se ky dokument është identik me dokumentin e paraqitur nga OE Victoria Invest shpk në lotin 4*

Ju theksojmë këto dokumente janë me emër objekti përkatësisht Objekti: loti 3 Mirëmbajtje me performancë Tiranë-Dajt-Qafë Mollë-Bizë, Qafë priskë –Shkallë-Shëngjergj-Uzina e Traktorit-Lanabregas Sauk Farkë 93.1 km Kontrata 3

Dhe gjithashtu në DT nuk ka asnjë kriter penalizimi për ngjashmëri të metodologjive të kompanive të ndryshme.

KVO është lodhur shumë duke krahasuar metodologjinë e cila është material përshkruar dhe nuk harxhon kohë që të verifikojë mjetet e paraqitura nga BOE dhe nga pjesëmarrësit e tjerë në lotet e tjera të cilët kanë paraqitur mjete të njëjta për të gjitha lotet , kontrata qeraje mjetesh pa emërtim objekti, me dokumentacion të mangët duke qenë në kundërshtim edhe me kriteret e dt. Ju sjellim në vëmendje se shërbimi i mirëmbajtjes rrugore do të kryhet me staf të specializuar dhe me mjete.

- *Pretendimeve të KVO së në këtë material nuk gjenden akset rrugore të kontratës nuk përshkruhet pozicioni i kantjerëve të përkohshëm (PMM) sidomos ato të dislokimeve të mjeteve pajsijeve dhe materialeve të mirëmbajtjes dimërore. Si dhe pretendimit se në fq 4 të kësaj metodologjie thuhet se do të ngrihen 2 qendra mirëmbajtje në kuptimin e kantierëve të cilat do të shërbejnë si pika ndërhyrjeje të domosdoshme sidomos në sezonin e dimrit në vijim përshkruhet vetëm njëra nga këto:*

Ju theksojmë se kjo metodologji është e titulluar me emër objekti ku përfshihen edhe segmentet rrugore përkatëse dhe si rrjedhojë gjatë përshkrimit të metodologjisë është përmendur fjala akse rrugore e cila nënkupton të gjitha akset rrugore të këtij objekti, gjithashtu në fq 4 figurën 2 pozita e infrastrukturës së rrugëve janë paraqitur në

formë skematike të gjithë akset rrugore të kësaj kontrate si dhe pozicioni i dy pikave Mbështetjes dhe Mirëmbajtjes PMM . Gjithashtu në këtë faqe shpjegohen se çfarë punimesh do të bëhen në këto 2 pika PMM përkatësisht në metodologji thuhet : Në lokacionet e përcaktuara për qendra (kantiere) operative PMM punohet rrethorja, ndërtohen strukturat e përkohëshme , sigurohen pajisjet e duhura, instalimet dhe infrastruktura informatike dhe telekomunikuese. Të gjitha këto përgatiten në përputhje me DT dhe specifikimet teknike. Që nënkupton që këto kantiere mbështetëse do të kenë pjesë përbërëse të tyre të gjitha makineritë dhe materialet e nevojshme sipas kërkesave të AK të cituara në DT dhe në specifikimet teknike.

Gjithashtu në fq 25 figura 8 skica e situatës të qendrës operative PMM është sqaruar në mënyrë skematike se çfarë do të ketë pjesë përbërëse në secilën pikë PMM. Si dhe është sqaruar përkatësisht: propozimet për pajisjet e planifikuara dhe fuqinë punëtore sipas vitit të kontratës së shërbimit janë treguar në formularin përkatës. Rregullimi i qendrës për mirëmbajtje operative pikave të mbështetjes dhe të mirëmbajtjes (PMM) do të punohet sipas kërkesave të investitorit për O&Mirëmbajtje. Në figurën 8 shtë treguar një variant i rregullimit të kantierit.

Për sa më sipër duket qartë se KVO nuk ka bërë një kontroll të saktë të materialeve të paraqitura nga OE në mënyrë tendencioze duke gjetur shkaqe ë pabazuara vetëm për të penalizuar OE Victoria Invest International -3 pikë .

Për këto arsye të cituara më sipër si dhe të evidentuara në materialin e paraqitur në mënyrë elektronike pranë AK kërkojmë që KVO të heqë penalizimin e vënë padrejtësisht me -3 pikë për OE Victoria Invest International shpk.

- Pretendimit të KVO që thotë se në dokumentat e OE Victoria Invest International shpk nuk evidentohet asnjë dokument plani i sigurimit teknik për të cilën e ka penalizuar OE me -1 pikë.

Ju theksojmë se ky pretendim nuk është i saktë për arsye se në DT e dorëzuara në mënyrë elektronike në dt 04.11.2020 Plani për sigurimin teknik ndodhet në dokumentin me emër Shëndeti dhe Siguria ne Punë me 26 fletë ku shpjegphen masat e sigurimit teknik për proceset e punëve si dhe pajisjet që duhet të zotërojë cdo punonjës në kantjer. Pra ky penalizim i KVO në mënyrë tendencioze është i padrejtë. Kërkojmë të hiqet ky penalizim.

- Pretendimit të KVO që thotë se në dokumentat e OE Victoria Invest International shpk se mungon plani i menaxhimit të aksidenteve dhe ndihmës së shpejtë për të cilën e ka penalizuar OE me -1 pikë: Ju theksojmë se plani për menaxhimin e aksidenteve është parashikuar në fq 23 të dokumentit Përshkrimi i metodologjisë dhe plani i punës ku janë të përshkruara metodologjia, skica , plan pune të dorëzuar në mënyrë elektronike në dt 04.11.2020. Plani i ndihmës së shpejtë është parashtruar në fq 17 të dokumentit Përshkrimi i metodologjisë dhe plani i punës paragrafi Aktivitetet emergjente dhe mbrojtja nga zjarri në të cilën është paraparë ndihma e shpejtë në rastet e 1 –Aksidente rrugore, 2- rrjedhjes së materialeve të rrezikshme, 3- Bartjes së

zjarrit nga zjarret malore dhe fuhsore përgjatë vijës së akseve rrugore, 4- dëmtimeve të mundshme në udhëtim dhe akteve të qëllimshme. Nqs KVO i referohet ndihmës së shpejtë mjekësore theksojmë se një DT nuk ka asnjë kërkesë që operatori ekonomik duhet të sigurojë pajisje dhe staf të specializuar për të ofruar shërbimin e ndihmës së shpejtë mjekësore në raste aksidentesh. Pra KVO ka bërë vlerësim në bazë të kërkesave të paparaqitura nga AK në DT. KVO nuk mund të penalizojë për këtë fakt për shkak të një kërkesë të pakërkuar në DT. Pra ky penalizim i KVO është i padrejtë. Kërkojmë të hiqet ky penalizim.

- Pretendimit të KVO që thotë se në dokumentat e OE Victoria Invest International shpk se mungon plani i menaxhimit social dhe mjedisor për të cilën e ka penalizuar OE me -1 pikë : Ju theksojmë se në DT nuk ka asnjë kërkesë që operatori ekonomik duhet të paraqesë planin për menaxhimin social dhe mjedisor. Përsa nuk është në kriteret kualifikuese të tenderit nuk ka si të merret si pikë vlerësimi dhe penalizim. Pra ky penalizim i KVO është i padrejtë. Kërkojmë të hiqet ky penalizim.

Të gjitha materialet e paraqitura në tender janë në gjuhë të kuptueshme në gjuhën shqipe.

Për të gjitha argumentat e mësipërme kërkojmë të hiqen këto penalizime të vëna padrejtësisht OE Victoria Invest International shpk dhe të vlerësohet me pikët maksimale 20 pikë për kriterin iii) Cilësia.

- Ju bëjmë me dije se veprimet e KVO arrijnë deri në shpërdorim detyre ku na vlerëson me të njëtin pikëzim për kriterin III përvoja në punë e kompanisë ndonëse kemi diferenca të theksuara në vlera dhe në punime të ngjashme mirëmbajtje rrugore dhe ndërtim rrugësh, asfaltim etj me BOE Xhast & Alb Shpresa&Mela shpk e cila ka paraqitur shumë herë me pak kontrata në vlerë financiare në krahasim me Victoria Invest International. Madje përfaqësuesi i BOE Xhast shpk ka shumë pak kontrata të ngjashme. Juve keni vlerësuar qëllimisht me diferencë të vogël pikësh të dy pjesmarrësit në këtë procedurë.

Oferta financiare e Victoria Invest International është 29,102,639 lekë me BOE Xhast&Alb Shpresa&Mela ndërsa KVO i ka dhënë pikët maksimale në dy kriteret e tjera përvoja në punë e kompanisë dhe cilësia në mënyrë të padrejtë.

- Gjithashtu i kërkojmë KSHA së AK që të verifikojë mjetet e paraqitura nga BOE me mjetet në kontratat e mirëmbajtjes rrugore që kanë në vazhdim me ARRSH (Drejtorinë e Rajonit Jugor, Qendror, Verior) te kontratat
- Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë rruga Ura e Leklit- Këlcyrë- Rruga Këlcyrë-përmet +Rruga Valare-Erind-cajup+Rruga K/Dhuvjan-Libohovë 63.6 km

- *Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Tepelenë-Dorrez-Qafë Dushk-Rruga sevaster-Kalivac 66.4 km.
Pasi ka paraqitur mjete të njëjta dhe duhet ta penalizoni me pikë minus për këtë fakt.*

Përfundimisht i kërkojmë AK që të pranojë ankesën sipas parashikimeve të mësipërme dhe të bëjë rivlerësim të pikëve sipas objektit të ankesës (dhe me llogaritjet përkatëse sipas përqindjes dhe vlerës së ofertuar) duke na dhënë neve ankuesit Victoria Invest International 20 pikë për kriterin iii Cilësia (dhe me llogaritjet sipas përqindjes dhe vlerës së ofertuar si dhe të bëni rivlerësim të pikëve për BOE Xhast& Alb Shpresa &Mela duke ulur pikët sipas parashtrimeve të mësipërme që ju kemi bërë:

Për kriterin i) cmimi më i ulët duke i ulur pikët dhe për kriterin ii) përvoja në punë e kompanisë duke e vlerësuar me 3.8 pikë (dhe me llogaritjet përkatëse sipas përqindjes dhe vlerës së ofertuar).

II.8. Në datën 07.12.2020 nëpërmjet shkresës me nr.9243/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.9. Në datën 11.12.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor por gjithashtu duke ngritur pretendime edhe lidhur me rivlerësimin e bërë nga autoriteti kontraktor datë 10.12.2020 i cili ka ulur akoma më tej pikët e ankimuesit me argumentat si më poshtë:

- *Në lidhje me rivlerësimin e bërë nga KSHA datë 10.12.2020 në faqen e APP dhe pretendimit të saj se: Ndërsa për disponueshmërinë e mjeteve për OE ankimues si rezultat i verifikimeve të pretendimeve nga OE tjetër pjesmarrës në këtë procedurë si dhe komunikimeve me Ministrinë e Infrastrukturës në Republikën e Kosovës , rezultoi se në sistemin elektronik të prokurimeve mungonte kontrata e qerasë midis kompanisë Damastion Project shpk dhe Victoria Invest International shpk si dhe mjetet e deklaruar në lotin 3 nga vetë ankuesi rezultojnë të deklaruar dhe angazhuara nga vetë qeradhënësi Damastion Project shpk në kontratën e mirëmbajtjes aktive në RKnë vijim jepen edhe mjetet e deklaruar të cilat rezultojnë të angazhuara nga vetë qeradhënësi Damastion Project shpk....*

I bëjmë me dije KPP se ky vlerësim i KSHA është në tejkallim të tagrave ligjorë të KSHA për fazën e dytë të vlerësimit të ofertave.

Në fazën e parë parakualifikuese AK ka bërë vlerësim të të gjithë dokumentacionit të kërkuar në DT sipas kriterëve të vecanta të kualifikimit që janë kriteret ligjore financiare profesionale dhe teknike. Pra i gjithë dokumentacioni për mjetet/pajisjet e kërkuara në pronësi ose qera është vlerësuar në fazën e parë të parakualifikimit të zhvilluar në datë 07 gusht 2020.

Në rast se AK ka pretendim për mungesë të disponueshmërisë së mjeteve (mosparaqitje dokument pronësie ose kontratë qeraje të mjeteve/pajisjeve dhe

angazhim të mjeteve në kontratë tjetër në RK) atëherë AK dhe KVO duhej të bënte skualifikim nga kjo procedurë prokurimi që në fazën e parë parakualifikuese të zhvilluar në datë 07 gusht 2020 dhe më pas si rrjedhojë të anulonte procedurën e prokurimit mqs kishte vetëm një operator të kualifikuar sic ka vepruar në procedurat e tjera të zhvilluara nga ARSSH në këtë periudhë sepse kjo procedurë prokurimi kërkonte minimalisht dy OE të kualifuar dhe jo të bëjë kualifikim në fazën e parë dhe më pas ulje të pikëve (vlerësimi i datës 23 nëntor 2020 në fq app Victoria Invest International vlera të ofertuara 282 dhe vlerësimi i datës 10 dhjetor 2020 në faqen e app Victoria Invest International vlera të ofertuara 267)

Në fazën e dytë kur dokumentacioni për paraqitjen e mjeteve/pajisjeve është verifikuar dhe vlerësuar në fazën e parë të zhvilluar në datë 07 gusht 2020.

I bëjme me dije KPP se në fazën e dytë të zhvilluar në datë 04.11.2020 kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar së bashku me deklaratë të datës 04.11.2020 në të cilën theksojmë se të gjitha mjetet e kërkuara do të jenë të disponueshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës. Gjithashtu kemi paraqitur edhe shtojcën e makinerive. Pra po jua ritheksojmë KPP se dokumentacioni i mjeteve në pronësi apo qera nuk është kërkuar në këtë fazë të dytë të kësaj procedure datë 04.11.2020 pasi është paraqitur dhe vlerësuar në fazën e parë parakualifikuese të datës 07 gusht 2020.

Dhe deklaratat e “disponueshmërisë së mjeteve” e plotëson kërkesën e përcaktuar në ftesën për ofertë për fazën e dytë datë 04.11.2020.

Pra në asnjë rast nuk lejohet KSHA që në fazën e dytë të procedurës të bëjë rivlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi në fazën e parë të procedurës dhe KPP në vendimet e saj shprehet se kur KSHA tejkalon tagrat e veta ligjore nuk merret parasysh asnjë nga vendim i saj.

Por sic theksuam më lart vendimi i KSHA për rivlerësim të procedurës për dokumentacionin e kërkuar nga AK në fazën e parë parakualifikuese duke ulur pikët për ankuesin Victoria Invest International shpk nuk duhet të shqyrtohet fare në themel nga KPP por të shpallet i pavlefshëm duke lënë në fuqi vendimin e KVO për vlerësimin e pikëve për Victoria Invest International të mesazhit të vlerësimit të datës 23.11.2020).

Qëndrime të ngjashme ka mbajtur edhe KPP në vendimet e saj KPP 89/2018 datë 01.03.2018, KPP 467/2018 datë 18.07.2018, KPP 649/2018 datë 02.10.2018, KPP 420/2018 datë 22.06.2018, KPP 108/2019 datë 27.02.2019.

Në fazën e dytë të të gjitha procedurave të mirëmbajtjes të gjitha shoqëritë pjemarrëse kanë paraqitur vetëm deklaratë për disponueshmërinë e mjeteve (dhe nuk kanë paraqitur dokument pronësie apo qeraje të mjeteve/pajisjeve të cilat ka qenë kriter kualifikues në fazën e parë të parakualifikimit dhe janë vlerësuar maksimalisht me pikë.

Pra AK në fazën e dytë të procedurës duhet të vlerësojë vetëm dokumentacionin e kërkuar sipas FTESE PËR OFERTË, për fazën e dytë dhe jo të vlerësojë dhe të penalizojë me pikë minus për kriteret kualifikuese të fazës parë parakualifikuese.

Ndërsa neve ankuesi penalizohemi pa të drejtë nga KSHA në fazën e dytë të procedurës për kërkesën e kualifikimit të fazës së parë parakualifikuese të kësaj procedure.

Pra arsyetimi i KSHA është tendencioz dhe i paligjshëm dhe i kërkojmë KPP që të mos ta marri parasysht këtë vlerësim të KSHA.

- *Në lidhje me arsyetimin e KSHA në shkrsën nr.9243/1 prot datë 07.12.2020 se mjetet e deklaruar në lotin 3 nga vetë ankuesi rezultojnë të deklaruar dhe angazhuara nga vetë qeradhënësi Damastion Project shpk në kontratën e mirëmbajtjes aktive në RK cka sjell që deklarata e bërë nga OE Victoria Invest International shpk mbi disponueshmërinë e mjeteve të jetë në kushtet e deklaratës së rremë.. Ju theksojmë se ky arsyetim i KSHA është totalisht i paligjshëm pasi shoqëria jonë ka paraqitur në tender deklaratë që : lejojmë AK të bëjë verifikimin e mjeteve si dhe deklarata që mjetet e paraqitura nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklarata nënkupton që mjetet që kemi paraqitur në tender nuk janë të angazhuara nga neve deklaruesi Victoria Invest International shpk në kontrata të tjera.*

Pra neve deklaruesi Victoria Invest International kemi marrë mjete me qera dhe këto mjete ne deklaruesi nuk i kemi të angazhuara në kontrata të tjera. Ndërsa se ku i ka të angazhuara qeradhënësi mjetet që jep me qera kjo nuk është pjesë e vlerësimit të AK. Pra arsyetimi i KSHA është tendencioz dhe i paligjshëm dhe i kërkojmë KPP që mos ta marri parasysht këtë vlerësim të KSHA.

I kërkojmë KPP që të anullojë penalizmin e pikëve të KVO dhe KSHA për Victoria Invest International për kriterin iii) Cilësia. Për të gjitha argumentat e mësipërme kërkojmë që të hiqen këto penalizime të vëna padrejtësisht OE Victoria Invest International shpk dhe që të vlerësohet me pikët maksimale 20 pikë për kriterin Cilësia.

Si dhe i kërkojmë KPP të pranojë ankesës sipas parashtrimeve të mësipërme dhe të bëjë rivlerësim të pikëve sipas objektit të ankesës (dhe me llogaritjet përkatëse sipas përqindjes dhe vlerës së ofertuar) duke na dhënë neve ankuesit Victoria Invest International 20 pikë për kriterin iii) Cilësia (dhe me llogaritjet sipas përqindjes dhe vlerës së ofertuar si dhe të bëni rivlerësim të pikëve për BOE Xhast& Alb Shpresa &Mela duke ulur pikët sipas parashtrimeve të mësipërme që ju kemi bërë:

Për kriterin i) cmimi më i ulët duke i ulur pikët dhe për kriterin ii) përvoja në punë e kompanisë duke e vlerësuar me 3.8 pikë (dhe me llogaritjet përkatëse sipas përqindjes dhe vlerës së ofertuar).

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 10024/1 prot., datë 28.12.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr.1714/2 datë 29.12.2020 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 30 pika 2 të **Vendimit nr.596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik**, në të cilin parashikohet se *“Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”*, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesave ka lidhje me vendimet dhe veprimet e tjera të autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar, parashikohet se: *“3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji,ka të drejtë:*

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;*
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;*
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;*
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”.*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Në datën 23.11.2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar procesin e vlerësimit të ofertave të dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së kufizuar. Konkretisht, referuar kriterit të përcaktimit të ofertës fituese *oferta ekonomike më e favorshme*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar në total me 93 nga 100 pikë bashkimin e operatorëve ekonomikë “Xhast” shpk & “Alb-Shpresa” shpk & “Mela” shpk si edhe me 94 nga 100 pikë operatorin ekonomik “Viktoria Invest International” shpk. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton se kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në datën

26.11.2020 ka paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor bashkimi i operatorëve ekonomikë Xhast” shpk & “Alb-Shpresa” shpk & “Mela” shpk të cilët kanë kundërshtuar vlerësimin me pikë në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Ndër të tjera, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka pretenduar se: “ Kundërshtojmë vlerësimin e bërë për operatorin tjetër Victoria Invest International dshh pasi Komisioni duhet ti jepte më pak pikë lidhur me disponueshmërinë e mjeteve. Nga informacionet tona ky operator ka paraqitur mjete të kompanisë mëmë në shtetin e Kosovës dhe mjete të tjera me qera të cilat janë të angazhuara në kontrata për mirëmbajtjen e rrugëve në Kosovë. Për këtë ky operator është në kushtet e deklaratës së rreme për disponueshmërinë e mjeteve gjatë periudhës së realizimit të kontratës/kontratave dhe sipas dst “Në rast të deklaramit të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13 pika 3 të gërma “a” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

III.1.2. Në datën 7.12.2020 me anë të shkresës nr.9242/2 datë 7.12.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues duke argumentuar ndër të tjera se:

Argumentimi i KSHA lidhur me uljen me -5 pikë të komponentit të tretë Cilësia të OE “Victoria Invest International”:

Lidhur me pretendimin e BOE Xhast & Alb Shpresa&mela shpk me kërkesën: Kundërshtojmë vlerësimin e bërë për operatorin tjetër Victoria Invest International dshh pasi komisioni duhet ti jepte më pak pikë lidhur me disponueshmërinë e mjeteve. Nga informacionet tona ky operator ka paraqitur mjete të kompanisë mëmë në shtetin e Kosovës dhe mjete të tjera me qera të cilat janë të angazhuara në kontrata për mirëmbajtjen e rrugëve në Kosovë. Për këtë ky operator është në kushtet e deklaratës së rreme për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës dhe sipas dt në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13 pika 3 gërma a e LPP”.... KSHA mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në SPE si dhe kërkoi nëpërmjet postës elektronike informacion në Departamentin e Menaxhimit të Rrugëve , Ministria e Infrastrukturës në Kosovë. Nga krahasimi i informacionit të ardhur në postën elektronike në datën 03.12.2020 me dokumentacionin e paraqitur në SPE rezultuan konstatimet e mëposhtme:

*OE Victoria Invest International dshh ka paraqitur deklaratën e mjeteve nga e cila rezulton se ka mjete në pronësi dhe me qera. Këto të fundit midis të tjerave janë marrë me qera në shtetin e Kosovës nga kompani të cilat ushtrojnë aktivitet në ndërtim dhe mirëmbajtje rruge. Kontrata e qerasë me një nga kompanitë në shtetin e Kosovës nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve. Megjithatë referuar kopjeve të dokumentacionit të mjeteve dhe makinerive të kompanisë qeradhënëse rezulton se janë të angazhuara nga vetë qeradhënësi Damastion Project shpk në kontratën e mirëmbajtjes aktive në Republikën e Kosovës **cka pas sjell që deklarata e bërë nga ana e OE Victoria Invest International shpk, dshh mbi disponueshmërinë e mjeteve të jetë në kushtet e deklaratës së rreme.** Në vijim jepet lista e mjeteve të deklaruara të cilat rezultojnë të angazhuara nga vetë qeradhënësi Damastion Project shpk...mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton, grejder, kamioncinë deri 3.5 ton, eskavator me goma, fadromë, eskavator me zinxhir.*

Nga sa më sipër nuk provohet disponueshmëria e mjeteve nga OE Victoria Invest International shpk dshh dhe referuar metodikës së pikëzimit, KVO duhet të bëjë rivlerësimin e pikëve lidhur me kriterin e cilësisë duke penalizuar edhe me 5 pikë këtë operator.

III.1.3. Në datën 10.12.2020 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kryer procesin e rivlerësimit të procedurës në zbatim të vendimit nr.9242/2 prot datë 07.12.2020 të KSHA duke ri vlerësuar me 93 nga 100 pikë bashkimin e operatorëve ekonomikë “Xhast” shpk & “Alb-Shpresa” shpk & “Mela” shpk si edhe me 89 nga 100 pikë operatorin ekonomik “Viktoria Invest International” shpk. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor për rivlerësimin e procedurës së prokurimit, operatori ekonomik “Viktoria Invest International” shpk ka ezauruar fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në datën 27.11.2020 dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 11.12.2020.

Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor, bazuar në ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë ka rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “Viktoria Invest International” duke ulur pikë përsa i përket komponentit “cilësia” duke argumentuar ndër të tjera se: *“OE Victoria Invest International dshh ka paraqitur deklaratën e mjeteve nga e cila rezulton se ka mjete në pronësi dhe me qera. Këto të fundit midis të tjerave janë marrë me qera në shtetin e Kosovës nga kompani të cilat ushtrojnë aktivitet në ndërtim dhe mirëmbajtje rruge. Kontrata e qerasë me një nga kompanitë në shtetin e Kosovës nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve. Megjithatë referuar kopjeve të dokumentacionit të mjeteve dhe makinierive të kompanisë qeradhënëse rezulton se janë të angazhuara nga vetë qeradhënësi Damastion Project shpk në kontratën e mirëmbajtjes aktive në Republikën e Kosovës **cka pas sjell që deklaratata e bërë nga ana e OE Victoria Invest International shpk, dshh mbi disponueshmërinë e mjeteve të jetë në kushtet e deklaratës së rreme.** Në vijim jepet lista e mjeteve të deklaruara të cilat rezultojnë të angazhuara nga vetë qeradhënësi Damastion Project shpk...mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton, grejder, kamioncinë deri 3.5 ton, eskavator me goma, fadromë, eskavator me zinxhir. Nga sa më sipër nuk provohet disponueshmëria e mjeteve nga OE Victoria Invest International shpk dshh dhe referuar metodikës së pikëzimit, KVO duhet të bëjë rivlerësimin e pikëve lidhur me kriterin e cilësisë duke penalizuar edhe me 5 pikë këtë operator.”*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin për prokurimin publik. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka përzgjedhur si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, ofertën ekonomike më të favorshme, bazuar kjo në nenin 55 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, autoriteti ka përcaktuar tre komponentë mbi të cilën do të kryhet edhe procesi i vlerësimit, Cilësia, Eksperienca dhe Cmimi me peshë specifike secilën prej tyre. Referuar komponentit “Cilësia”, në dokumentet e procedurës, autoritetit ka sqaruar se në këtë komponent përfshihen: *“Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit*

kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi” Gjithashtu, në shtocjën 10 “Kriteret e Veccanta të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka parashikuar se: “2.3.11 Makinerite e mesiperme nuk duhet të jene të angazhuara në kontrata të tjera. Për këto të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa ”a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.**”

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjen me vend të ndalet në dy pyetje kërkimore, të cilat do të shërbejnë mbi zgjidhjen e konfliktit administrative objekt gjykimi:, së pari me momentin procedural që mund të ngrihen pretendime mbi dokumentacion të rremë për qëllime kualifikimi dhe mbi tagrat dhe kompetencat e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi konstatimin e një deklarimi të rremë për qëllime kualifikimi. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se lloji i procedurës së përzgjedhur nga ana e autoritetit kontraktor është procedurë e kufizuar në kuptim të nenit 31 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, procedurë e cila është me faza, ku në fazën e parë operatorët ekonomikë dorëzojnë dokumentacionin ekonomik-financiar dhe teknik për kualifikim ndërsa në fazën e dytë, vetëm operatorët e para kualifikuar paraqesin njëherazi edhe ofertën ekonomike sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht se këto dy faza janë faza të ndryshme procedurale. Ndërkohë, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nuk mund të anashkalojë një rregullim specifik që ka parashikuar ligjvënësi në nenin 47 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku thuhet se: “*Autoriteti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës. Autoriteti kontraktor për çdo skualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji*” Në rastin konkret, ligjvënësi ka parashikuar si momentin procedural që mund të kryhet verifikimi i dorëzimit të dokumentacionit të rremë për qëllime kualifikimi, ashtu edhe organi që e kryen atë. Konkretisht, neni 47 i ligjit për prokurimin publik parashikon se skualifikimi për paraqitjen e dokumenteve të rreme shtrihet në çdo kohë deri në momentin e lidhjes së kontratës. Kështu, autoriteti kontraktor ndodhet brenda afateve procedurale të konstatimit dhe skualifikimit të ofertës së operatorëve ekonomikë në kushtet kur ky i fundit ka paraqitur deklaram të rremë për qëllime kualifikimi. Sa më sipër, në shtrirjen e së drejtës në kohë, për konstatimin e dorëzimit të dokumentacionit të rremë për qëllime kualifikimi, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ndodhet brenda afatit procedural, pasi kufizimi i vetëm lidhet me momentin e lidhjes së kontratës. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit) KPP konstaton se në relacionin e ndryshimeve të ligjit për prokurimin publik, konkretisht të nenit 47 të ligjit, ndryshuar me ligjin nr. 47/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar është argumentuar se: “*Pra, për ta bërë më të qartë këtë fazë, deri kur autoriteti*

kryen verifikime propozohet që të qartësohet shprehja e përdorur në këtë nen duke zëvendësuar fjalët “deri në fazën e shpalljes së kontratës” me “deri në momentin e lidhjes së kontratës” Gjithashtu, është ndryshuar edhe emërtimi i këtij neni “Skualifikimi i ofertuesve” në “Raportimi i skualifikimit”, kjo për ta lidhur me përmbajtjen e tij.” Konkretisht, qëllimi i ligjvënësit ka qenë të qartësojë të drejtën e autoritetit kontraktor për të kryer verifikime mbi dorëzimin e deklaratave /dokumenteve të rreme për qëllime kualifikimi deri në momentin e lidhjes së kontratës. Gjithashtu, KPP konstaton se ligjvësi nuk ka parashikuar se cila strukturë mund të kryejë konstatimin, (KVO, KSHA), kompetencat e të cilëve janë rregulluar qartësisht në rregullat për prokurimin publik, por ka nënvizuar se **është autoriteti kontraktor** përgjegjës për të kryer këto verifikime, pra përfshirë një nga strukturat e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk mund të rivlerësojë me një nivel më të ulët pikët për komponentin përkatës “Cilësia” me arsyetimin se operatori ka paraqitur të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, por duhet të zbatohet parashikimet e nenit 47 të ligjit nr.9643 dtë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, të skualifikojë operatorin ekonomik dhe të ndjekë veprimet procedurale të parashikuar nga ky nen. Është përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktor, i cili ka kryer verifikimet e nevojshme dhe ka konstatuar se operatori ekonomik ka dorëzuar një deklaratë të rremë, konkretisht, deklaratën në mbështetje të kriterit 2.3.11 të shtojcës 10 të dokumenteve të procedurës së prokurimit, për sa kohë që kjo është konstatuar nga autoriteti kontraktor dhe brenda momentin procedural të njohur nga ligji (para nënshkrimit të kontratës).

Sa më sipër, në zbatim të nenit 30 pika 2 të **Vendimit nr.596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik**, në të cilin parashikohet se “2. Përbërësit, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre” Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk mund të shqyrtojë në themel pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për kundërshtimin e vlerësimit me pikë ndaj këtij të fundit, pasi ky operator ekonomik, referuar konstatimeve të autoritetit kontraktor duhe të ishte skualifikuar në zbatim të nenit 47 të ligjit për prokurimin publik. Konstatimi i paraqitjes së dokumentacionit të rremë, në kuptim të nenit 47 të ligjit për prokurimin publik, nuk mund të passjellë uljen e pikëve të operatorit ekonomik ankimues, por kryerjen e veprimit procedural të skualifikimit të këtij të fundit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria Invest International” shpk për procedurën e prokurimit “E Kufizuar (mbi kufirin e larte monetar)”, me nr. REF-65730-07-16-2020, me objekt “Loti 3 : “Mirëmbajtje me performancë Tiranë - Dajt - Qafë Mollë - Bizë, Qafë Priskë - Shkallë – Shëngjergj, Uzina e Traktorit - Lanabregas, Sauk - Farkë”, me fond limit 255,787,340.00 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 04.11.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë parashikimet e nenit 47 të ligjit nr.9643 dtaë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, duke skualifikuar operatorin ekonomik “Victoria Invest International” shpk dhe të ndjekë veprimet proceduriale të parashikuar nga ky nen.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Victoria Invest International” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1714 Protokolli; Datë 11.12.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri